



Emri ndryshon kur lidhet me fjalë të tjera në fjali. Ndryshimi që pëson emri kur përdoret në fjali quhet **lakim**. Format e ndryshme që merr emri në fjali quhen rasa.

Lexo këto fjali me kujdes, do ta shihni emri shok nuk e ka formën e njëjtë. Për të dalluar rasat e emrave të gjinisë mashkullore bëjmë pyetjen: **cili?**

1. **Shoku** im recitoi bukur.
2. Recitimi **i shokut** më pëlqeu.
3. Librin e gjuhës ia dhashë **shokut**.
4. **Shokun** e klasës e takova në tren.
5. E mora fletoren **prej shokut**.



Në gjuhën shqipe ka pesë rasa: emërore, gjinore, dhanore, kallëzore e rrjedhore. Kemi katër tipa lakimi. Lakimet dallohen sipas mbaresës që marrin emrat në trajtën e shquar të rasës emërore të njëjësit. Ndarja e emrave në lakime përkon në vija të përgjithshme me ndarjen e tyre në gjini:

- ★ Lakimi **i parë** përfshin emrat e gjinisë mashkullore që marrin mbaresën – **i**, p.sh: treni, lapsi, vëllai etj..
- ★ Lakimi **i dytë** përfshin emrat e gjinisë mashkullore që marrin mbaresën – **u**, p.sh : shoku, dheu, miu, ujku etj.
- ★ Lakimi **i tretë** përfshin emrat e gjinisë femërore që marrin mbaresën – **a** ose – **ja**, p.sh.: fusha, kumbulla, vajza, shoqja, lulja etj.
- ★ Lakimi **i katërtë** përfshin emrat e gjinisë as njëjës që marrin mbaresën – **t (ë)** ose **-it**, p.sh. : të ftohtë-t, të verdhët, të zi-të, të ecurit etj.

Po japim disa pasqyra të këtyre lakimeve, nga të cilat shihet se ç'mbarena marrin emrat në rasat e ndryshme.

1. Lakimi i parë

Numri njëjës

Rasa	Trajta e pashquar	Trajta e shquar
Emërore	(një) mal	mal -i
Gjinore	(i, e) (një) mal-i	(i, e)mali-t
Dhanore	(një) mal-i	mali-t
Kallëzore	(një) mal	mal-in
Rrjedhore	(një) mal-i	mali-t

2. Lakimi i dytë

Numri njëjës

Rasa	Trajta e pashquar	Trajta e shquar
Emërore	(një) shok	shok-u
Gjinore	(i, e) (një) shok-u	(i,e) shok-t
Dhanore	(një) shok-u	shok-t
Kallëzore	(një) shok	shok-un
Rrjedhore	(një) shok-u	shoku-t

3. Lakimi i tretë

Numri njëjës

Rasa	Trajta e pashquar	Trajta e shquar
Emërore	(një) vajzë	vajza
Gjinore	(i, e) (një) vajz-e	(i, e) vajzës
Dhanore	(një) vajz-e	vajzës
Kallëzore	(një) vajz-ë	vajzën
Rrjedhore	prej (një) vajz-e	prej vajzës

Rasa	Trajta e pashquar	Trajta e shquar
Emërore	(një) anije	anij-a
Gjinore	(i, e) (një) anije-je	(i, e) anije - s
Dhanore	(një) anije-je	anije-s
Kallëzore	(një) anije	anije-n
Rrjedhore	(një) anije-je	anije-s

4. Lakimi i katërt

Numri njëjës

Rasa	Trajta e pashquar	Trajta e shquar
Emërore	(një) të ftohtë	të ftohtë - t
Gjinore	(i, e) (një) të ftoht-i	(i, e) të ftohti - t
Dhanore	(një) të ftoht-i	të ftohti - t
Kallëzore	(një) të ftohtë	të ftohtë - t
Rrjedhore	(një) të ftoht-i	të ftohti - t

Ushtrohu

1. Lidh me shigjetë rasën me emrin.

- Emërore • • aeroplanin
- Gjinore • •prej aeroplanit
- Dhanore • •aeroplanit
- Kallëzore • •aeroplani
- Rrjedhore • • i aeroplanit



Detyrë . Shkruaj pesë fjali ku emri të jetë në rasi të ndryshme.